



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0579**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Medi Health” L.L.C. kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të ”Ministria e Shëndetësisë ” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për njësite organizative te QKUK-se” LOT 8 me nr. të prokurimit: “206-23-11488-1-1-1”, me 27/08/2024, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Medi Health” L.L.C. me nr. 2024/579, e datës 01/07/2024, vendimi për dhënie të kontratës “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për njësite organizative te QKUK-se” LOT 8 të anulohet dhe aktiviteti i prokurimit për këtë LOT të anulohet në tërësi në mungesë të ofertave të përgjegjshme.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Medi Health” L.L.C.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 24.10.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për njësite organizative te QKUK-se” me nr. të prokurimit: “206-23-11488-1-1-1”. Ndërsa me datën 28.05.2024 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Agro Med” SH.P.K. ne vlere totale prej 84,900.00 Euro.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 1,630,005.00 €.

Me 01.06.2024, OE “Agro Med” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 21.06.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Medi Health” L.L.C. me nr. 2024/579 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për njësite organizative të QKUK-se” me nr. të prokurimit: “206-23-11488-1-1-1”.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Medi Health” L.L.C janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare: “Oferta e Operatorit Ekonomik Ankues “Health Health” LLC, Me lidhje me procedurat e fillimit për lotin 8, fillimisht me datën 02.04.2024 është vendi si përgjegjshme dhe si e tillë është rekomanduar për dhënien e kontratave, nga komisioni profesional i autorizuar nga vet AK - MSH, është edhe një zyrtar i autorizuar i prokurimit, rrjedhim arsyetimi i eliminimit të ofertës | sonë pas procesit të ri rezultatit paraqet shkelje të Nenit 52.3, 56.3 dhe 59 i LPP se. Për këtë procedurë të prokurimit të shkeljeve ligjore janë konsumuar edhe shkelje procedurale me qëllimin e vetëm dëmtimin e buxhetit, favorizimin e OE tani rekomanduar dhe diskriminimin e kompanive sonë ankuese. Ne përfundimin fillestar ne si operator ekonomik jemi për dhënie të kontratës (prove njoftimin e publikuar ne e prokurim). Pas rekomandimit për dhënien e kontratës së AK - MSH, ka pranuar kërkesë për rishqyrtim nga OE “Argo Med” ShPK me datën 07.04.2024. Kundrejt kësaj kërkesë Autoriteti Kontaktues - MSH, gjegjësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit nxjerr vendimin rreth 23 dite pas afatit ligjor, aprovon të njëjtën gjë dhe lëndën e kthen në rivlerësim përkundër faktit se nuk ka kurrfarë baze ligjore. Ky veprim tregon qarte për negociimin e mundshëm, keqpërdorimin e publikut, madje edhe pas aktivitetit ekonomik “AgroMed” ShPK propozohet për kontrate. Favorizimi dhe qëllimi i vërtetë i ndodh në tregohet në vendimin e datës 30.04.2024, ku AK - MSH, aprovon kërkesën për të qëndruar në OE “Argomed” ShPK, lënda kthehet në pasojat e një rreziku dhe në anën tjetër potencohet përgjegjshmëria e saj. te njëjtit OE dhe aty me arsyetimin se pajisja nuk pozon UPS dhe aparatën për kalibrim siç është kërkuar në pika 7.3 dhe 7.4. te specifikave teknike të detyrueshme për lotin 8. Kompania jone nuk afatin e rregullimit për dhënien e kontratave për OE “Argomed” ShPK,

pas ri rezultatit të ofertave, gjegjësisht arsyetim e eliminimit të ka kundërshtuar me datën 01.06.2024, sipas kërkesave për ri ... AK - për të trajtuar MSH, për të trajtuar këtë kërkesë, për të tentuar për manipuluar me prova dhe dëshmi për të abuzuar me parane publike nxjerr vendime të refuzuara dhe atë pas 20 ditëve të gjegjësisht me datën 20.06.2024 refuzon kërkesën tone si te pa kush! Nenin 108/A, par 6 te LPP-se kjarre përcakton afatin për vendosje dhe nxjerrje te vendimit ku i njëjti afat është jo me shume se 3 dit pune dhe ne raste komplekse mund te vazhdohet afati edhe për 3 dite tjera por duhet te nxirret vendim i veçante për zgjatje te afatit. “Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragraf 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuar mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë”, Veprimet recidiviste te tilla duhet te raportohen dhe duhet te kërkohet te ndermirën masa ligjore meqë mos respektimi i rregullave për trajtim te kërkesës për ri shqyrtim pran AK, sipas pikës e) te nenit 97, te rregullores nr. 001/2022, konsiderohet si shkelje e rende. Kjo përgjegjësi do duhej te bie mbi zyrtarin përgjegjës te prokurimit, për këso veprimesh recidive do duhej te inicohej procedure ne kuptim te nenit 25.8,te LPP-se dhe te njoftohet KRPP, me këto veprime. Përkundër faktit se ne vendim ndaj kërkesës për ri shqyrtim te nxjerre ditën e 23, (ne rivlerësimin fillestar), përkatësisht ne ditën e 20 (ne vendimin e dyte te datës 20.06.2024), ne vend se te trajtohen pretendimet ankimore te arsyetohen veprimet dhe eliminimi i ofertës sonë, kërkohet mëshirë, kërkohet mirëkuptim, tanohet te shpëtohet nga përgjegjësia ligjore, gjegjësisht arsyetimit te pretendimeve tone iu jepet konotacion vajtues dhe përshkruhet se si pacientet po trajtohen jashtë vendit, se si ka qene zyrtari i obliguar te prese përgjigje, apo dhe nuk ka pranuar përgjigje nga prodhuesi ynë B.Branun, madje edhe konfirmimi i prodhuesit deformohet, rrjedhimisht akuzohemi ne si kompani pse kërkojmë përgjigje për shkelje ligjore!.”

Pretendimi i dyte (II) : “Operatori Ekonomik ankues, pas nxjerrjes se vendimit - refuzimit te kërkesës për ri shqyrtim te datës 20.06.2024, i është drejtuar AK-se, me kërkesë për qasje ne dokumente për këtë procedure te prokurimit, përkundër kësaj AK - MSH, nuk ofron qasje dhe nuk përgjigjet fare ndaj kërkesës sonë te parashtruar me datën 26.06.2024. Prove: Kërkesa për qasje ne dokumente e datës 26.06.2024.AK-MSH, ka ofruar qasjen dhe me këto veprime ka konsumuar shkelje nga neni 10 i LPP-se nga paragrafi 3 deri ne paragrafin 5 ku përcaktohet: 3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të këtë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 ahe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. 4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni ne mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave. 5. Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t ’i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni. Mos ofrimi i qasjes ne dokumente publike, konsiderohet si shkelje e rende e këtij ligji bazuar ne nenin 97, te Rregullores me nr. 001/2022, për prokurim publik pika c) c. Mos

lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.”

Pretendimi i trete (III) “Arsyetimi i eliminimit të kompanisë sonë me përshkrimin e poshtë përshkruar dhe arsyetimi i përshkruar në vendimin e datës 20.06.2024 është abuzues dhe ka qëllim të caktuar. AK - MSH, pajisjen tone e deformon dhe e quan “Bbraun OMNI Ecco2R”, përderisa pajisja jone e ofertuar quhet “Bbraun OMNI”, rrjedhimisht katalogu i prezantuar në ofertën tone deformohet keqinterpretohet dhe tentohet të manipulohet dhe nuk i referohet pozicioneve dhe përshkrimeve të nënvizuara dhe nuk krahasohet me kërkesat e dosjes së tenderit apo specifikacionet teknike të detyrueshme. Aparati, gjegjësisht pajisja e prezantuar në oferte të prodhuesit “Bbraun OMNI”, i realizon të gjitha funksionet e specifikave teknike të detyrueshme përfshirë edhe TPE. AK - MSH, me qëllim të manipulimit dhe eliminimit të ofertës sonë, këtë e shpërfaq hapazi në shkresa dhe përshkruan se në si kompani nuk kemi prezantuar setin për kryerjen e funksioneve CRRT dhe TPE, kjo gjë nuk qëndron, pasi kompania jone në ofertën e prezantuar ka ofruar të gjitha llojet e Sete-ve që ofron prodhuesi për këtë pajisje, të cilat mund të gjeni në dokumentin e prezantuar në oferte me titull: “2. OMNIbrochure e nënvizuar-Specifikimi teknik pjesa e trete” në faqen 12, ku është i përfshirë edhe produkt OMNI Set Plus me të cilin mund të trajtohet si e konfirmuar nga vete prodhuesi, përveç kësaj kemi ofruar edhe setin për “OMNIECCO2R”, set ky i cili nuk është kërkuar në dosje të tenderit apo specifika teknike të detyrueshëm por me këtë kemi dashur të tregojmë që produkti ynë “Bbraun OMNI”, përveç që realizon të gjitha funksionet e kërkuara në FDT, trajton edhe largon CO2 nga gjaku I pacientit dhe ky fakt është dhe do duhej të ishte shumë i rëndësishëm për pacientet të cilët i nënshtrohen këtij trajtimi. Arsyetimi se pajisja jone nuk plotëson pikën a) dhe b), nuk është asgjë tjetër përveç manipulimit dhe tentimit të keqpërdorimit i parasë publike dhe dispozitave ligjore apo shtrembërimit të gjendjes faktike. Ky insistim për manipulim, keqpërdorim, abuzim dhe eliminim të ofertës sonë do duhej të mbetet vetëm në tentative dhe nuk do duhej të lejohej të konkretizohej, pasi që pajisja jone “BBraun OMNI” i plotëson të gjitha kriteret dhe specifikacionet teknike ashtu siç është kërkuar.” Në vlerësimin fillestar të ofertave pikërisht për këtë procedurë në si OE jemi rekomanduar për dhënie të kontratës, ku sipas raportit të vlerësimit fillestar të ofertave anëtarët e komisionit vlerësues kanë qenë profesionist të fushës dhe objektit të kontratës. Aparati dhe produkti ynë largon të gjitha komponentet patogjene nga plazma e gjakut (këtë e ka konfirmuar edhe përgjigja e prodhuesit) term ky i cili përdoret për të gjithë shkaktarët e gjendjes septike, përkatësisht pastron gjakun nga çdo komponent toksik, rrjedhimisht ky produkt dhe kjo pajisje është nder pajisjet me të përsosura dhe si e tillë i plotëson të gjitha specifikat teknike të aplikuar në dosje të tenderit. Madje aparatura dhe produkti BBraun OMNI, përveç funksioneve të aplikuar ofron edhe funksione tjera në dobi të pacientëve. Prove: Dëshmitë nga katalogu i prodhuesit të pajisjes “B.Braun”, sa i përket pikave të eliminimit. Pra arsyetimi i eliminimit të kompanisë sonë, nuk është asgjë tjetër përveç tentimit për keqpërdorim dhe abuzim me parandë publike. Arsyetimi se në nuk kemi prezantuar “Sebet” është absurd, pasi që është kërkuar, që së bashku me aparaturën të dorëzohen setet për Plazma Exchange (30), SEPSIN (30) dhe të gjitha format e CRRT (nga 10), rrjedhimisht nuk është

kërkuar qe pajisja ti këtë te inkorporuar këto produkte dhe te njëjtat produkte sipas aneksit 1 - Specifikacionet teknike te detyrueshme janë materiale hargjuese dhe për te njëjtat nuk është kërkuar dëshmi apo katalog siç është kërkuar për pajisjen kryesore. Për te gjitha specifikat e kërkuara te produktit ne kemi prezantuar katalogun, kemi prezantuar deklaratat dhe dëshmitë tjera te cilat janë pjese e ofertës, janë pjese e sqarimeve dhe plotësimeve sipas kërkesës se AK-se. Te gjitha këto janë dëshmuar janë prezantuar dhe AK — MSH është ne dijeni me këto fakte. Cili është qëllimi i eliminimit tentimit te abuzimit do duhej te vërtetohej ne procedure tjetër. Ne në oferte kemi prezantuar deklaratën qe do ti ofrojmë setet e kërkuara, gjegjësisht specifikacionet teknike te detyrueshme “Braun OMNI”, dhe specifikimet e nënvizuara te pajisjes. Për këtë qeshje AK - MSH, ka kukuar sqarime shtese, ne kemi ofruar sqarim por prap AK - MSH, deformon gjendjen faktike, te cilën ne asnjë rrethane nuk do te lejojmë te deformohet. I gjithë arsyetim i eliminimit apo tentativa për eliminim te ofertës, konsumon shkelje ligjore nga neni 52.3 dhe 56.3 te LPP-se ku shprehimisht përcaktohet: “Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Për këtë qeshje AK - MSH, zyrtaret përgjegjës te saje tek arsyetimi i eliminimit te ofertës sonë, gjegjësisht ne arsyetimin e dhënë ne vendimin e datës 20.06.2024, për kundër faktit se ka marr konfirmim nga prodhuesi i pajisjes BBraun se pajisja e trajton SEPSSEN, AK-MSH deformon përgjigjen dhe konfirmimin e dhënë nga prodhuesi i pajisjes dhe me ngulm deklaron se pajisja nuk e trajton SEPSSEN. Ngjashëm AK MSH, ne te njëjtin vendim potencon se pajisja nuk disponon filterat, përkundër faktit se prodhuesi BBraun, sipas përgjigjes se datës 20.06.2024, ka potencuar se pajisja është kompatible me filterat e prodhuesve tjerë për te cilët ne si kompani kemi ofruar deklarate dhe kemi konfirmuar se do te ofrojmë produktet e tilla ashtu siç është përcaktuar ne DT dhe specifikacione teknike te detyrueshme. Prove:Komunikimi i AK - MSH, dhe përgjigjeje e prodhuesit “Braun” e datës 20.06.2024.AK - MSH, zyrtari përgjegjës i prokurimit, për këtë procedurë te prokurimit ne vazhdimësi tenton te lajthis vendim marrjen te lajthis zyrtaret tjerë përfshirë edhe anëtarët e komisionit ri vlerësues te ofertave si dhe ne përgjigje ndaj kërkesës sonë për ri shqyrtim te datës 01.06.2024, deformon kërkesat kualifikuese, deformon specifikacionet teknike për pajisjen e lotit 8, dhe me këto veprime për manipulim dhe mashttrim ne prokurim publik. Ne dosje te tenderit, ne aneksin 1 te DT-se shume qarte përcaktohet qe për pajisjen e lotit 8, nga pika 5 për produktet dhe për setet për te cilat tentohet te eliminohet kompania jone është përcaktuar qe: “ OE duhet te ofroje dhe dorëzojë se bashku me aparatit Setet e kërkuara si dhe siguroje disponueshmeri për te gjitha setet" rrjedhimisht për këto produkte dhe materialin hargjues te pajisjes AK- MSH nuk ka kërkuar, katalog apo kërkesë tjetër kualifikuese ne Dosje te Tenderit, por ne përgjigjen e Kërkesës tone për Rishqyrtim te datës 20.06.2024. Zyrtari i AK-MSH del jashtë kërkesave te FDT-se dhe deklaron se ne nuk kemi ofruar dokumente si Autorizimi, CE Certifikata, Katalogu për piken 5 te Dosjes se Tenderit, ne te cilën askund nuk përmenden këto dokumente, por vetëm kërkohet qe te dorëzohen se bashku me pajisjen. 6. Prove: përshkrimi i aneksi 1 te DT-se për lot 8, pika 5.”

Pretendimi i katërt (IV) : “Ne anën tjetër, Autoritet Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, ka rekomanduar për dhënie të kontratës oferte të pa përgjegjshme në aspektin financiar dhe aspektin teknik të konfirmuar me vendimin e vet AK - MSH të datës 30.04.2024, por çuditërisht tani e njëjta oferta u bë e përgjegjshme dhe rekomandohet për dhënie të kontratës. Pajisja e prezantuar dhe ofertuar nga Operatorit Ekonomik “Argomcd ShPK”, përmban çmim dukshëm më të lartë se oferta jone, nuk i plotëson specifikat teknike të detyrueshme dhe këto veprime paraqesin shkelje ligjore dhe shkelin kriterin e dhënies çmimit me të ulët dhe kjo dërgon në keqpërdorim të parasë publike dhe dëmton të buxhetit të sanksionuar me LPP dhe ligje tjera. Vet AK - MSH në vendimin e datës 30.04.2024 ka potencuar se oferta e të njëjti është e pa përgjegjshme. Prove: Arsyetimi i vendimit të AK - MSH, i datës 30.04.2024. Por këtë pretendim ankimore të kompanisë tone që e kemi cekur në Kërkesën për Rishqyrtim, AK - MSH, sipas vendimit të datës 20.06.2024, të nxjerr jashtë afatit ligjorë nuk e ka trajtuar fare dhe me këtë ka shkelur dispozitat e nenit 108\A të LPP-se, paragrafi 8 pika 4. 8. Autoriteti Kontraktues do ta refuzojë një kërkesën për rishqyrtim kur: 8.4 Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi. AK - MSH, përgjatë proceseve të ri vlerësimit me çdo kusht kërkon rekomandimin dhe lidhjen e kontratës me oferte të kundërligjshme e cila nuk i plotëson specifikacionet teknike të detyrueshme të vetë konfirmuara. Sipas kërkesave për sqarim në si OE dyshojmë thellë se AK - MSH, ka pranuar përgjigje, ka pranuar dokumente dhe ka pranuar produkte të cilat fare nuk kanë qenë pjesë e ofertës, rrjedhimisht pranon plotësim të ofertës në aspekt material e cila është e ndaluar rreptësisht sipas dispozitave ligjore për prokurim publik si tërësi dhe nenit 59 në veçanti. Në Aneksi I- Specifikacione teknike të detyrueshme në pikën 7.3 dhe 7,4, është kërkuar që pajisja të posedoj UPS dhe aparatën për kalibrim të pajisjes, gjë të cilën Operatori Ekonomik “Argo Med ShPK” nuk e ka ofruar, kjo e konfirmuar nga vetë AK-MSH. “

Prandaj, bazuar në provat dëshmitë dhe faktet e prezantuara si më sipër, kërkojmë që OSHP, fillimisht për trajtim të kësaj ankese të autorizoj ekspert të fushës, me kualifikim profesional nga fusha NEFROLOGJISE, dhe në kuptim të nenit 113, të LPP-se, të trajtohen të gjitha pretendimet tona ankimore në aspektin teknik dhe sa i përket aspektit ligjorë të autorizohet ekspert shqyrtues ligjorë njohës i dispozitave ligjore dhe i pa anshëm pavarur, në atë mënyrë që paneli shqyrtues të nxjerr këtë: VENDIM I. Të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e OE “Medi Health” si e bazuar. II. Të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 27.05.2024, për lotin 8, si i kundërligjshëm dhe lënda të kthehet në Rivlerësim; III. Të kualifikohet si e përgjegjshme oferta e OE ankues: “Medi Health” LLC - Prishtinë, me çmimin me të ulët; IV. Të lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të ankesës dhe V. Të ndërmerren masa ligjore ndaj zyrtareve përgjegjës për veprime dhe mos veprime kundërligjore të përcaktuara me dispozita ligjore dhe të argumentuara me prova, sipas nenit 25.8, të LPP-se.

Duke u mbështetur në nenin 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 12.07.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0579, ndërsa me datë 08.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/0579 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa AK ta anulojë aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit, njesoj edhe OE nuk pajtohet me mendimin e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Medi Health” L.L.C. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0579 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK fillimisht ka rekomanduar për kontratë OE ankuesin aktual, kurse OE të rekomanduarin ARGOMED SHPK e shpalle të pa suksesshëm. I cili kërkesën për rishqyrtim ka parashtruar me datë 07.04.2024 ndërsa AK kthen vendimin për aprovim të kërkesës me datë 30.04.2024 e cila është në kundërshtim me nenin 108/A par 6 të LPP-së, duhet të shqyrtoj kërkesën brenda 3 dite, gjithashtu mund të zgjatet jo më shumë se 3 ditë tjera. Vendimi pas rivlerësimit publikohet me datë 28.05.2024 në të cilën rekomandohet OE Argomed, ndërsa OE ankues eliminohet me arsyetimin, Sqarojmë se, AK nuk ka eliminuar OE të rekomanduarin aktual, mirëpo në rivlerësim të ofertave kërkon sqarime shtesë nga i njëjti me datë 23.05.2024 citat:

*Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:*

*Për pajisjen e ofruar nga ana juaj BAXTER PRISMA FLEX për Lot 8 - Pajisja Aferezë kërkojmë te na sqaroni me dëshmi ne lidhje me kërkesën e me poshtme: Suitable maintenance free battery UPS for minimum one-hour backup shall be supplied with the system.*

*Pajisja e ofertuar nga ana juaj e ka të instaluar sistemin e bateri back up mirpo koha e back-up është vetëm 10 minuta kurse kërkesë nga Dosja e Tenderit ka qenë minimum 1 orë.*

*Kërkojmë te na sqaroni dhe konfirmoni me shkrim ne lidhje me baterinë UPS dhe a mundeni te na furnizoni me UPS që e mban pajisjen në punë gjatë kohës kur nuk ka Energji Elektrike me minimum 1 orë, te na ofroni dëshmi me shkrim për këtë kërkesë. Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të na i dërgoni përmes e-prokurimit sa me shpejtë qe keni mundësi, por me se largu deri me date 28.05.2024 ne ora 16:00.*

Për të cilën kërkesë për sqarim, me datë 24.05.2024 ofron edhe deklaratën tjetër, në rastin konkret, ekspertja teknike sqaron se, në katalog nuk specifikohet koha e back up (UPS) për 1 orë sipas kërkesës së AK-së në aneks 1 tek specifikat teknike, gjithashtu edhe OE i rekomanduar ka deklaruar që nuk e posedon në katalog por mund ta furnizoj shtesë me një autonomi së paku 1 orë që do të jetë në funksion gjatë gjithë periudhës garantuese, mirëpo kjo pajisje nuk është ofruar në ofertë para hapjes tek katalogu sipas specifikave të DT-së pika 7.3, andaj ekspertja shqyrtuese konsideron se kjo shtesë paraqet ndryshim material, dhe si e tillë e refuzon ofertën. Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Konstatimi i dytë (II) : *OE ankues pretendon se nuk ka dhënë qasje në ofertën e OE të rekomanduar andaj edhe ka shkelë nenin 10.5 të LPP-së. (më lartë tek pretendimet ankimore e gjeni pretendimin e plotë ankimore).*

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë sqaron se, OE ankues pas vendimit për rivlerësim, me datë 26.06.2024 ka kërkuar qasje në ofertën e OE të rekomanduar, mirëpo bazuar në shkresat e lëndës të dokumentuara në E-prokurim, kërkesa për qasje nuk gjendet në E-prokurim, përderisa OE ankues posedon dëshmi e-mail, mirëpo bazuar ne nenin 10 dhe 11 të LPP-së, AK duhet që të ofroj qasje në versionin e pastruar, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Konstatimi i trete (III) :Ekspertja teknike ka analizuar specifikacionet teknike te cilat janë kërkuar ne DT dhe pas analizimit te tyre ka ardhur ne përfundim:

Pika 2.2 – tek Aneks 1 -The possibility of treating septic conditions – Sipas kesaj pike ne DT ku OE ankues nuk e plotëson këtë kërkesë të specifikacioneve teknike pasi qe pajisja e tyre nuk e ka mundësinë për të trajtuar kushtetet septike sepse nuk mund të përdoret TPE (Shkëmbimi terapeutik i plazmes) e cila ka rol kyq deri te mbledhja e qelizave burimore të gjakut periferik.- Nuk i përmbush specifikimet teknike.

Pika 5.2 në aneks 1-Nuk keni prezentuar ne katalog 30 sete per terapi të shkëmbimit të plazmës te cilat jane bazike per garancionin e pajisjes e cila eshte me se e nevojshme per te pasur nje siguri ne te ardhmen duke e ditur kohezgjetjen e trajtimit te pacienteve dhe te cilat duhet te dokumentohen sipas DT dhe duhet te vijne se bashku me pajisjen – Nuk i përmbush specifikimet teknike.

Konstatimi i katërt : Ekspertja teknike e potencon dhe e vlereson se OE ankues nuk i përmbush specifikimet teknike te kerkuara sipas kërkesave në DT, andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Si përfundim, ekspertja shqyrtuese bazuar në përgjigjet e ekspertes teknike lidhur me specifikat teknike, meqenëse dy ofertuesit nuk i plotësojnë specifikat teknike sipas kërkesës së AK-së në DT, atëherë rekomandon që lënda për LOT 8 të anulohet konform nenit 43.5 të RRPP-së nr.001/2022 pika b:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme.

b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Medi Health” L.L.C. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Medi Health” SH.P.K. janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –



Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, ka pasur nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ka qenë e nevojshme të dëgjohen edhe palët.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Medi Health” L.L.C. te aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur tja fal besimin raportit të ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për njësite organizative të QKUK-se” LOT 8 me nr. të prokurimit: “206-23-11488-1-1-1”, dhe aktivitetin e prokurimit për këtë LOT të anulohet në tërësi në mungesë të ofertave të përgjegjshme sipas konstatimit të dy ekspertëve.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Medi Health L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: